



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 26 dhjetor 2017  
Nr. ref.: RK 1179/17

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI120/17**

Parashtrues

**Hafiz Rizahu**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të  
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës  
për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,  
nr. AC-I-17-0132, të 1 gushtit 2017**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare.

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Hafiz Rizahu nga fshati Malishevë, komuna e Gjilanit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Halit Azemi, avokat nga Gjilani.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), nr. AC-I-17-0132, të 1 gushtit 2017, dhe Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit, nr. AC-II-12-0006, të 8 dhjetorit 2016.
3. Aktvendimi i Kolegjit të Apelit, nr. AC-I-17-0132, iu dorëzua parashtruesit të kërkesës më 7 gusht 2017.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuar, me të cilat pretendohet se është shkelur e drejta e parashtruesit të kërkesës e garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 10 tetor 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 12 tetor 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.
8. Më 16 tetor 2017, Gjykata informoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që t'i dorëzojë Gjykatës autorizimin për përfaqësimin e parashtruesit para Gjykatës.
9. Në të njëjtën datë, kërkesa iu dërgua Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme) dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP).
10. Më 30 tetor 2017, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës e dorëzoi autorizimin që dëshmon se ai është i autorizuar që ta përfaqësojë parashtruesin e kërkesës para Gjykatës.
11. Më 7 dhjetor 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.



## Përmbledhja e fakteve

12. Më 9 shkurt 2006, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Dhomën e Posaçme kundër Ndërmarrjes Shoqërore N.SH.-KBI "Agrikultura" nga Gjilani (në tekstin e mëtejme: ndërmarrja shoqërore) për lirim dhe dorëzimin në posedim të parashtruesit të ngastrës kadastrale nr.1651, në vendin e quajtur "Zabeli i Sahit Agës", e evidentuar në fletën poseduese me nr. 7267, KK Gjilan (në tekstin e mëtejme: parcela e kontestuar), duke pretenduar se ndërmarrja shoqërore kundërligjshëm e kishte uzurpuar pronën e tij dhe kishte ndërtuar fermë të pulave në të.
13. Më 22 mars 2006, Dhoma e Posaçme me Aktvendim [nr. SCC-06-0051] e referoi padinë te Gjykata Komunale në Gjilan [në tekstin e mëtejme: Gjykata Komunale]. Palët ishin këshilluar që ankesa eventuale kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale do të duhej të parashtrohej në Dhomën e Posaçme.
14. Më 21 shkurt 2011, ndërmarrja shoqërore parashtroi kundërpadi ndaj parashtruesit të kërkesës, duke kërkuar njohjen e të drejtave pronësore mbi parcelën e kontestuar si dhe duke pretenduar se parcelën e kontestuar e ka pasur në posedim prej vitit 1960, kur ishte krijuar ndërmarrja shoqërore.
15. Më 13 shtator 2011, Gjykata Komunale (Aktgjykimi C. nr. 241/2006), aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit, duke i njohur parashtruesit të kërkesës të drejtën e pronësisë në një pjesë të parcelës së kontestuar dhe e refuzoi kundërpadinë e ndërmarrjes shoqërore.
16. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale (C. nr. 241/2006), ndërmarrja shoqërore dhe AKP paraqitën ankesa në Dhomën e Posaçme. Ndërmarrja shoqërore pretendoi *"shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të së drejtës materiale"*, ndërsa AKP, mes tjerash, kontestoi edhe kompetencën e Gjykatës Komunale për të vendosur për rastin.
17. Më 8 dhjetor 2016, Kolegji i Apelit (Aktgjykimi AC.II-12-0006) aprovoi pjesërisht ankesat e ndërmarrjes shoqërore dhe të AKP-së, duke ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale (Cnr.341/2006) si dhe duke e njohur të drejtën e pronësisë për parashtruesin e kërkesës për vetëm një pjesë të ngastrës për të cilën Gjykata Komunale i kishte njohur të drejtën e pronësisë. Aktgjykimi i cekur më lart ishte përfundimtar dhe i paapelueshëm.
18. Më 28 shkurt 2017, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit (Aktgjykimi AC. II-12-0006) në Gjykatën Themelore në Gjilan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) *"për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe shkeljes së të drejtës materiale."*
19. Më 6 prill 2017, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për rishqyrtimin e Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit (Aktgjykimi AC. II-12-0006) në Kolegjin e Apelit për të njëjtat arsye që kishte paraqitur revizionin.

20. Më 28 prill 2017, Gjykata Themelore (Akti përcjellës C. nr. 341/2006) përcolli revizionin në Gjykatën Supreme, ndërsa më 2 qershor 2017 (Akti përcjellës Rev. nr. 123/2017) Gjykata Supreme i përcolli revizionin Dhomës së Posaçme.
21. Më 1 gusht 2017, Kolegji i Apelit (Aktvendimi nr. AC-I-17-032), hodhi poshtë si të papranueshme revizionin dhe kërkesën për rishqyrtim të procedurës të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit (Aktgjykimi AC. II-12-0006). Kolegji i Apelit, mes tjerash, arsyetoi se:

*“Kolegji i Apelit vlerëson se në bazë të nenit 10 paragrafi 14 i Ligjit Nr. 04/L-033 të Dhomës së Posaçme [...], të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e Kolegjit të Apelit të DHPGJS janë të prera dhe nuk i nënshtrohen asnjë apeli tjetër. LDHP sikurse edhe Shtojca e tij nuk parashohin mjetin e jashtëzakonshëm juridik kundër aktgjykimeve ose aktvendimeve të Kolegjit të Apelit të DHPGJS [...].”*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Kolegji i Apelit (Aktgjykimi nr. AC-II-12-0006 dhe Aktvendimi AC-I-17-0132) ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.
23. Parashtruesi specifikon se *“Uzurpimi i pronësisë private është bërë pa kurrfarë baze juridike e as materiale por në mënyrë arbitrare. Pronësia private [është] e pacenuar dhe e garantuar me Ligj, dhe se është shkelur e drejta e pronësisë në bazë të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.”*
24. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata që *“për shkak të shkeljes esenciale të procedurës kontestimore [...] të mos vërtetimit të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale”* të prishet Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit (AC-II-12-0006) i 8 dhjetorit 2016 dhe çështja të kthehet në rigjykim.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

25. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.  
[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

27. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit, që përcakton:



*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

28. Gjykata i referohet edhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili parasheh:

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...].”*

29. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 (Kriteret e pranueshmërisë), (1) (b) dhe (c) të Rregullores, që parasheh:

*“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

*[...]*

*b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjyqimit të kundërshtuar;*

*c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi [...].”*

30. Gjykata rikujton se afati 4 (katër) mujor fillon nga “vendimi i fundit” në procesin e shterjes së mjeteve juridike me të cilin është refuzuar kërkesa e parashtruesit (shih *mutatis mutandis*, rasti i GJEDNJ-së, *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 46477/99, Vendim i 14 marsit 2002).
31. Gjykata rikujton po ashtu se parashtruesi duhet t'i shterojë të gjitha mjetet juridike të cilat pritet të jenë efektive dhe të mjaftueshme. Vetëm mjetet efektive mund të merren parasysh nga Gjykata, pasi parashtruesi nuk mund të zgjat afatet kohore strikte të parapara me Ligj dhe Rregullore të punës, duke u përpjekur të ushtrojë mjete juridike në institucionet të cilat nuk kanë kompetencë që të ofrojnë mbrojtje të të drejtave për të cilat ankohet parashtruesi i kërkesës (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 14881/04, Vendim i 5 janarit 2006,).
32. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se procedura ndaj parashtruesit e zhvilluar para gjykatave të rregullta në lidhje me meritat e rastit të tij kishte përfunduar me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit (AC. II-12-0006) të 8 dhjetorit 2016 .
33. Në lidhje këtë, Gjykata i referohet Aktvendimit të Kolegji të Apelit (AC.-I-17-032) që konstatoi se “në bazë të nenit 10 paragrafi 14 i Ligjit Nr. 04/L-033 të *Dhomës së Posaçme [...]*, të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e Kolegjit të Apelit të DHPGJS janë të prera dhe nuk i nënshtrohen asnjë apeli tjetër.”
34. Gjykata po ashtu i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore, ku kishte konstatuar se: “[ë] shtë tërësisht e qartë se vendimet e DHPGJS-së nuk mund të jenë objekt i asnjë lloji procedure të mëtutjeshme qoftë edhe gjyqësore, përveç objekt i

*trajtimin në Gjykatën Kushtetuese.” (shih, Aktvendimi për rastin KIo2/15, parashtrues: Qendra Shoqërore, Kulture, Sportive, Ekonomike "Pallati i Rinisë", Aktvendim për papranueshmërinë, i 18 majit 2015, paragrafi 29).*

35. Gjykata rikujton se, në rastin e parashtruesit, pas pranimin të Aktgjykimit nga Kolegji i Apelit (AC-II-12-0006) i 8 dhjetorit 2016, asgjë nuk e ka ndaluar atë t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, ai ka përdorur mjete juridike, si revizionin dhe kërkesën për rishqyrtim të Aktgjykimit (Nr. AC-II-12-0006), të cilat nuk kanë qenë të parapara me ligj.
36. Rrjedhimisht, si “vendim i fundit”, sipas nenit 49 të Ligjit normalisht do të jetë Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit (AC-II-12-0006) i 8 dhjetorit 2016, me të cilin ishte ndryshuar Aktgjykimi i Gjykatës Komunale (C. nr. 241/2006) dhe i cili ishte përfundimtar dhe i paapelueshëm (shih, *mutatis mutandis*, *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 46477/99, GJEDNJ, Vendim i 14 marsit 2002).
37. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit (Aktgjykimi nr. AC-II-12-0006) ishte nxjerrë më 8 dhjetor 2016. Edhe pse parashtruesi nuk ka çekur datën e pranimin të Aktgjykimit, nga faktet e rastit, është e qartë se koha në mes të pranimin të Aktgjykimit dhe të datës së parashtrimit të kërkesës së tij, më 10 tetor 2017, në Gjykatën Kushtetuese, ka kaluar periudhën kohore prej 4 (katër) muajsh.
38. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit në lidhje me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit (AC-II-12-0006) është dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh.
39. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri ligjore, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'i kontestuar (Shih, rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendimi i 25 gushtit 2005, shih, edhe: rastin nr. KI140/13, *Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmërinë, të 17 marsit 2014, paragrafi 24).
40. Nga arsyet e cekura më lart, Gjykata konstaton se kërkesa nuk i përmbush kriteret procedurale për pranueshmëri të kërkuara me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, andaj, si e tillë kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme.

## PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, më 7 dhjetor 2017, njëzëri

## VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

  
Altay Suroy



  
Arta Rama-Hajrizi